



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**

Nr. 9199 Prot.

Tiranë, më 26/01 2018

**UDHËZIM**

Nr. 05 datë 26/01 2018

**MBI  
PROCEDURAT STANDARDE TË FUNKSIONIMIT TË  
SEKTORIT TË VLERËSIMIT QENDROR  
DHE  
SEKTORIT TË KONTROLLIT APOSTERIOR OPERATIV**

Në zbatim të nenit 10, 47 dhe 51, të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017 Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.921, datë 29.12.2014 "Për personelin e administratës doganore", të ndryshuar ,

**UDHËZ O J:**

**I. ORGANIZIMI I DHE FUNKSIONIMI I SEKTORIT TË VLERËS NË QENDËR (SVQ) DHE SEKTORIT TË KONTROLLIT APOSTERIOR OPERATIV (SKAO)**

1. SVQ operon në përputhje me rregulloret përkatëse të funksionimit të këtij sektori dhe strukturën organizative në fuqi duke mbuluarorarin e shërbimit të zyrave doganore.
2. SVQ është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit doganor në fuqi lidhur me verifikimin dokumentar të të gjitha deklaratave të përzgjedhura automatikisht për këtë sektor nga sistemi Asycuda World, në kanal të verdhë dhe të kuq, në procedurat e zgjeruara 4000, 4071 dhe 4700 dhe 4771 (kutia 37 e DAV). Kjo qendër, nuk do të shqyrtojë deklaratat e përzgjedhura nga sistemi në kanal blu apo jeshil.

3. SKAO operon në përputhje me rregulloren përkatëse të funksionimit të këtij sektori dhe strukturën organizative në fuqi sipas orarit zyrtar të punës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.
4. SKAO është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit doganor në fuqi lidhur me verifikimin dokumentar të të gjitha deklaratave të përzgjedhura në kanalën Blu për këtë sektor, në procedurat e zgjeruara 4000, 4071 dhe 4700 dhe 4771 (kutia 37 e DAV), si dhe një përqindje e deklaratave të pranuar në ditën paraardhëse me qëllim rikontrolli.
5. Përqindja e deklaratave të pranuar në sistem nga kanalet e tjera, përpos atyre blu, me qëllim rikontrolli, kryhet në bazë të ngarkesës si dhe elementëve të riskut. Kriteret e përzgjedhura përcaktohen nga Sektori i Përpunimit të të Dhënave dhe Analizës në bashkëpunim me strukturat e TI, dhe mund të jenë të ndryshueshme.

## **II. KONTROLLI SIPAS KANALIT TË PËRZGJEDHJES**

1. Deklaratave në çdo rast ju caktohet një kanal kontrolli (jeshil, blu, i verdhë, i kuq).
2. Punonjësit doganorë në funksion të detyrës që kryejnë, kanë përgjegjësi:
  - të ndjekin procedurat e parashikuara për kanalën e caktuar;
  - të respektojnë me rigorozitet kërkesat e parashikuara në kriterin e përzgjedhjes;
  - të përmbushin masat e përcaktuara në mesazhin e profilit të riskut që ka përzgjedhur deklaratën doganore, por pa u limituar vetëm në masat e mesazhit - në asnjë rast nuk duhen anashkaluar gjetje të cilat nuk i korrespondojnë mesazhit, por që përbëjnë shkelje doganore.
3. Deklaratat e përzgjedhura në kanalet blu dhe jeshil (me afat të limituar kohor për çlirimin e mallrave) mund të rikanalizohen në kanale të tjera me nivel më të lartë risku. Strukturat dhe mënyra e rritjes së nivelit të riskut përcaktohet sipas Manualit Udhëzues “Mbi Menaxhimin e Riskut dhe të drejtën e kontrollit bazuar në analizën e riskut”.

## **III. PROCEDURAT QË NDIQEN NGA SVQ**

1. **Përzgjedhja në kanalën e verdhë**
  - 1.1. Nëse deklarata është përzgjedhur në kanalën e “*verdhë*”, kjo do të thotë se ajo deklaratë do t’i nënshtrohet verifikimit dokumentar.
  - 1.2. Sistemi AW i mundëson personelit të SVQ shpërndarjen automatike të deklaratave doganore. Nëse kjo shpërndarje për shkaqe objektive nuk realizohet automatikisht, përgjegjësi i turnit të SVQ, kryen shpërndarjen bazuar në ngarkesën e punës së personelit në varësi.
  - 1.3. Nëse, si rrjedhojë e shpërndarjes automatike të deklaratave doganore, konstatohet që një deklaratë është caktuar gabimisht nga sistemi për t’u procesuar më tej nga SVQ, Përgjegjësi i SVQ kontakton menjëherë formë elektronike (e-mail), me Përgjegjës të Turnit/Zyrës/Pikës operacionale në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata

doganore në adresën e dedikuar '@dogana.gov.al'/Asycuda World, i cili manualisht duhet të kryejë rishpërndarjen bazuar në ngarkesën e punës së personelit në varësi.

1.4. Doganieri i SVQ verifikon:

- nëse dokumentet shoqëruese të deklaratës janë të besueshme dhe nëse i plotësojnë kërkesat e parashikuara nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore;
- nëse të dhënat e deklaruara përputhen me ato që përmbajnë dokumentet shoqëruese;

1.5. Më pas vijon me kontrollin për saktësinë e të dhënave që përmban një deklaratë doganore:

- a) Klasifikimin tarifor;
- b) Origjinën e mallrave;
- c) Licenca, leje, autorizime, etj. (në rast se importi i mallrave kushtëzohet prej tyre);
- d) Vlerësimin doganor;
- e) Etj.

**a) Kontrolli mbi klasifikimin tarifor**

Në lidhje me kontrollin e klasifikimit tarifor doganieri i kontrollit dokumentar sigurohet që:

a.1) përshkrimi tregtar i mallit t'i korrespondojë përshkrimit të kodit tarifor të deklaruar sipas Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave (NKM). Klasifikimi tarifor duhet të verifikohet nëse është në përputhje me Rregullat e Përgjithshme të Interpretimit, Shënimet e Seksionit dhe Kapitullit përkatës. Në rast se ekzistojnë ende paqartësi në lidhje me klasifikimin tarifor, atëherë duhet të konsultohen Notat Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar të OBD apo të BE.

*Për shembull:*

- *T'i kushtohet vëmendje pozicioneve 'përgjithësuese', emërtimeve të tilla si 'të tjera – të tjera – të tjera' dhe sidomos në rastet kur niveli tarifor i kodit me përshkrimin 'të tjera' është më i ulët se niveli tarifor i kodeve tetëshifrore të të njëjtit kre të NKM.*
- *T'i kushtohet vëmendje mallrave të cilat janë të përbëra nga pjesë të ndryshme (sete, duzina, komplete) nëse plotësohen kushtet e rregullit Interpretues të NKM 3b, që ka të bëjë me klasifikimin e "mallrave të vendosura në grupe për shitje me pakicë".*
- *T'i kushtohet vëmendje klasifikimit të mallrave për të cilat ka udhëzime klasifikimi nga DPD.*

a.2) operatori ka aplikuar për Informacion Detyrues Tarifor (ITD) dhe klasifikimi tarifor i dhënë me ITD i korrespondon në çdo detaj mallit të deklaruar. T'i kushtohet vëmendje plotësimin të kodit përkatës shtesë në sistemin AW në rubrikën përkatëse të DAV për ITD e lëshuara. Nëse ka paqartësi për ITD, mund të kërkohet mendim më i specializuar pranë Sektorit të Tarifës.

a.3) është kyer më parë një verifikim dhe analizë e të njëjtit lloj malli nga Laboratori Doganor, me qëllim përcaktimin dhe klasifikimin tarifor të mallrave.

**b) Kontrolli mbi origjinën e mallrave**

Në lidhje me kontrollin e origjinës së mallrave doganieri i kontrollit dokumentar sigurohet që:

b.1) prova e origjinës të jetë lëshuar në momentin e eksportit ose kur eksporti është siguruar. Vërtetimi i origjinës preferenciale është i vlefshëm për katër muaj nga data e lëshimit në palën eksportuese, dhe duhet depozituar brenda kësaj periudhe tek autoritetet doganore;

b.2) formulari i certifikatës EUR.1 duhet të përmbajë ekstremitetet dhe kushtet e parashikuara në protokollin përkatës të rregullave të origjinës preferenciale në Marrëveshjet e Tregtisës së Lirë në fuqi (MTL);

b.3) të krahasohen vultat e Certifikatave të Origjinës EUR.1 (në kutinë nr 11) me specimentet e përcjella nga doganat homologe; dhe

b.4) të verifikohet formati i numrit të autorizimit në rastet e deklaratave-faturë të lëshuara nga eksportues të miratuar, me modelet e përcjella nga doganat homologe apo Komisioni Europian;

b.5) vlera totale e produkteve origjinuese nuk duhet t'i kalojë 6,000 euro nëse prova e origjinës është një deklaratë-faturë;

b.6) Në rastet e deklaratave-faturë të lëshuara nga eksportuesit duhet të sigurohet që:

- teksti i deklaratës të origjinës në faturë (apo në ndonjë dokument tjetër tregtar) është sipas anekseve përkatëse të MTL-ve, si dhe
- firma origjinale të eksportuesit është e shkruar me dorë (përjashtim nga firma origjinale bën eksportuesi i miratuar, i cili mund të mos i nënshkruajë këto deklarata);

b.7) operatori ka aplikuar për Informacion Detyrues të Origjinës (IDO) dhe origjina e dhënë me IDO i korrespondon në çdo detaj mallit të deklaruar. T'i kushtohet vëmendje plotësimit të kodit përkatës shtesë në sistemin AW në rubrikën përkatëse të DAV për IDO e lëshuara. Nëse ka paqartësi për IDO, mund të kërkohet mendim më i specializuar pranë Sektorit të Origjinës;

b.8) të zbatohen kushtet dhe udhëzimet (nëse ka të tilla) për mallra të caktuara;

b.9) të konsultohet baza e të dhënave e shkeljeve doganore, nëse është kyer më parë një verifikim nga homologët lidhur me origjinën e mallit për produktin në fjalë, nga i njëjti vend origjine i deklaruar në DAV.

**c) Licenca, leje, autorizime, etj. (në rast se importi i mallrave kushtëzohet prej tyre);**

Në rast se importimi i mallrave kërkon plotësimin e kushteve të veçanta (licenca, leje, autorizime, ndalime/kufizime), këto kërkesa verifikohen paraprakisht nga doganieri i SVQ.

#### **d) Kontrolli dhe shqyrtimi i vlerës doganore**

Në lidhje me kontrollin dhe shqyrtimin e vlerës doganore, doganieri i kontrollit dokumentar sigurohet që:

d.1) deklarimi doganor përputhet me të dhënat dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur;

##### *Për shembull:*

- vlerat e faturave shoqëruese të blerjes janë të njëjta me ato të deklaruara në DAV;
- monedha e deklaruar në DAV përkon me atë të shprehur në faturat shoqëruese;
- vlera e treguar në faturat shoqëruese është në përputhje me urdhrat e blerjes, kontratat, korrespondencat, etj. T'i kushtohet vëmendje nëse ekzistojnë reduktime ose kompensime në faturat e blerjes, si pasojë e transaksioneve të tjera;
- kushti i lëvrimit të mallrave dhe mënyra e pagesës të deklaruar në DAV, përputhet me dokumentacionin e mallrave;

d.2) rubrikat përkatëse të DAV-it janë të plotësuara në mënyrë korrekte dhe pa mangësi;

d.3) referencat (numër/datë) dhe kodifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur DAV pasqyrohet në mënyrë korrekte;

d.4) fatura që shoqëron mallrat përmban elementët kryesorë për kryerjen e vlerësimit doganor, të tilla si: numri i artikujve, sasia, çmimi për njësi, numri, data, përshkrimi i mallit, kushti i lëvrimit të mallrave;

d.5) Kur doganieri i SVQ, mbështetur në analizën e riskut, ka dyshime të arsyeshme se vlera e deklaruar e transaksionit nuk përfaqëson shumën totale të paguar ose të pagueshme, siç referohet në pikën 1, të nenit 66, të Kodit, mund të kërkojë nga deklaruesi të japë informacione shtesë (në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor, Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore) dhe gjithashtu deklaruesi është i detyruar që të japë informacion dhe dokumente shtesë lidhur me:

- vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura;
- informacion ose dokumente shtesë, të nevojshme, për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave.

Në çdo rast, informacioni shtesë duhet të shërbejë vetëm për qartësimin e deklarimit fillestar, por pa e cenuar atë.

d.6) Në qoftë se përsëri mbeten dyshime, doganieri i SVQ mund të vendosë që vlera e mallit nuk mund të përcaktohet në përputhje me pikën 1, të nenit 66, të Kodit. Doganieri i SVQ, mbështetur në nenin 7.3, të Marrëveshjes për Zbatimin e nenit 7, të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT 1994), informon deklaruesin për Aktin e Vlerësimit. Akti i Vlerësimit plotësohet sipas Aneksit 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe duhet të sqarojë dyshimet e arsyeshme, rivlerësimin dhe metodën e vlerësimit të përdorur për llogaritjen e vlerës doganore të mallit të importuar. Ky formular bëhet pjesë e deklaratës doganore duke iu bashkëlidhur dokumentave të tjera të praktikës doganore. Në versionin elektronik në AW plotësohen referencat përkatëse për dokumentin me kodin 903.

Njëkohësisht, në të gjitha rastet e rivlerësimit, nga ana e doganierit të kontrollit dokumentar do të ndërhyhet në rubrikën 43 të DAV-it për metodën e vlerësimit doganor si dhe në

rubrikën 45 të DAV-it me koeficientin e ri të vlerës së mallit të rivlerësuar. Në këtë rast, krijohet një version i ri i deklaratës, të cilin sistemi e ruan së bashku me deklaratën origjinale.

d.7) Akti i Vlerësimit i njoftohet, në formë elektronike (e-mail), deklaruesit (në adresën e depozituar pranë autoriteteve doganore) dhe Degës Doganore (Përgjegjës Zyre/Turni /Pike, në adresën zyrtare '@dogana.gov.al'/Asycuda World Mail) ku është depozituar deklarata doganore.

d.8) Brenda 10 ditëve nga informimi, deklaruesi mundet të ankohet me shkrim ndaj aktit të vlerësimit pranë degës doganore ku është depozituar deklarata. Dega Doganore komunikon në formë elektronike (e-mail), me personelin e SVQ në adresën e dedikuar '@dogana.gov.al'/Asycuda World nëse nevojiten sqarime të mëtejshme në lidhje me Aktin e Vlerësimit. Vendimi i arsyetuar i Kryetarit të Degës Doganore i komunikohet me shkrim deklaruesit brenda 5 ditëve nga depozitimi i ankimit. Kundër vendimit, personit të interesuar i lind e drejta e ankimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Në këtë rast, nenet 281 dhe 282, të Kodit, aplikohen *mutatis mutandis*.

d.9) Nëse gjendja e llogarisë nuk mbulon ndryshimet e bëra lajmërohet deklaruesi për të bërë pagesat përkatëse duke shtuar shumën korresponduese në llogarinë parapaguese.

d.10) Vetëm pasi në sistem të jenë reflektuar dhe pranuar ndryshimet e mësipërme, Përgjegjësi i turnit në SVQ miraton çlirimin për konsum të mallrave duke kryer veprimet përkatëse në sistemin AW, deklarata konsiderohet e pranuar dhe sistemi cakton automatikisht një numër serial që fillon me 'P'. Ky numër (numri i pranimit) do të shfaqet në rubrikën 'B' të DAV.

d.11) Përgjegjësi i Turnit/Zyrës/Pikës operationale në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, pas marrjes së numrit serial 'P' dhe 'M', kryen këto veprime:

- firmos e vulos me vulën datore në rubrikën 'C' të DAV. Vula duhet të përmbajë shënimin: "U zhdoganua";
- printon në format A4 Urdhrin e Çlirimit;
- i jep deklaruesit kopjen e DAV që i takon atij bashkë me Urdhrin e Çlirimit.

d.12) Në rastin e aplikimit të nënshkrimit elektronik, Përgjegjësi i SVQ pas marrjes së numrit serial 'P' dhe 'M' firmos elektronikisht në DAV. Në këtë rast Përgjegjësi i Turnit/Zyrës/Pikës operationale në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, printon në format A4 Urdhrin e Çlirimit dhe i jep deklaruesit kopjen e DAV që i takon atij bashkë me Urdhrin e Çlirimit.

#### **e) Konstatimi i shkeljeve doganore**

e.1) Nëse nga verifikimet që kryen, doganieri i kontrollit dokumentar gjen mospërputhje apo parregullsi në deklaratë (shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore), rezultatet e kontrollit të kryer dhe/ose gjetjet përkatëse përshkruhen në mënyrë të detajuar në Aktin e Kontrollit në AW. Në çdo rast, plotësohet edhe Akti i Vlerësimit sipas Aneksit 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi, si dhe informohet deklaruesi dhe Dega Doganore për Aktin e Vlerësimit. Akti i Vlerësimit i njoftohet në formë elektronike (e-mail), deklaruesit (në adresën e depozituar pranë autoriteteve doganore) dhe Degës Doganore (Përgjegjës Zyre/Turni/Pike, në adresën zyrtare '@dogana.gov.al'/Asycuda World Mail) ku është depozituar deklarata doganore.

e.2) Ky formular bëhet pjesë e deklaratës doganore duke iu bashkëlidhur dokumentave të tjera të praktikës doganore. Në versionin elektronik në AW plotësohen referencat përkatëse për dokumentin me kodin 903. Në këtë rast krijohet një version i ri i deklaratës, të cilin sistemi e ruan së bashku me deklaratën origjinale.

e.3) Në vijim, Përgjegjësi i Zyrës/Turnit/Pikës dhe Specialisti/koordinatori me DPD apo në Përgjegjësi i Zyrës/Turnit/Pikës dhe specialisti përkatës pranë Kryetarit të Degës Doganore (për Degët Doganore që nuk kanë Specialist/koordinator me DPD), duhet të plotësojnë edhe Procesverbalin e Verifikimit të Shkeljeve (bazuar në Aktin e Vlerësimit dhe Aktin e Kontrollit në AW), sipas Manualit Udhëzues Mbi Zbatimin e Dispozitave Lidhur me Shkeljet në Fushën Doganore dhe Akcizës. Procedurat në vijim, pas hartimit të Procesverbalit të Verifikimit të Shkeljeve përcaktohen në manualin e sipërcituar. Në rastin e aplikimit të nënshkrimit elektronik, Procesverbali i Verifikimit të Shkeljeve do të hartohet dhe nënshkruhet nga doganieri përkatës i SVQ dhe Përgjegjësi i SVQ.

e.4) Vendimi i arsyetuar i Kryetarit të Degës Doganore merret në përputhje me nenin 276 të Kodit Doganor. Kundër vendimit, personit të interesuar i lind e drejta e ankimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në përputhje me nenet 281 dhe 282, të Kodit Doganor.

e.5) Vetëm pasi në sistem të jenë reflektuar dhe pranuar ndryshimet e mësipërme, Përgjegjësi i turnit në SVQ miraton çlirimin për konsum të mallrave duke kryer veprimet përkatëse në sistemin AW, deklarata konsiderohet e pranuar dhe sistemi cakton automatikisht një numër serial që fillon me 'P'. Ky numër (numri i pranimit) do të shfaqet në rubrikën 'B' të DAV.

e.6) Përgjegjësi i Turnit/Zyrës/Pikës operacionale në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, pas marrjes së numrit serial 'P' dhe 'M', kryen këto veprime:

- firmos e vulos me vulën datore në kutinë C të DAV. Vula duhet të përmbajë shënimin: "U zhdoganua";
- printon në format A4 Urdhrin e Çlirimit;
- i jep deklaruesit kopjen e DAV që i takon atij bashkë me Urdhrin e Çlirimit.

e.7) Në rastin e aplikimit të nënshkrimit elektronik, Përgjegjësi i SVQ pas marrjes së numrit serial 'P' dhe 'M' firmos elektronikisht në DAV. Në këtë rast Përgjegjësi i Turnit/Zyrës/Pikës operacionale në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, printon në format A4 Urdhrin e Çlirimit dhe i jep deklaruesit kopjen e DAV që i takon atij bashkë me Urdhrin e Çlirimit.

## **2. Përzgjedhja në kanal të kuq**

2.1. Nëse deklarata përzgjidhet në kanalin e kuq, kjo do të thotë se për atë deklaratë zbatohen fillimisht procedurat që lidhen me verifikimin e gjendjes fizike të mallrave dhe më tej ato që lidhen me verifikimin dokumentar. Sistemi AW i mundëson personelit të Degës Doganore shpërndarjen automatike të deklaratave doganore. Nëse kjo shpërndarje për shkaqe objektive nuk realizohet automatikisht, Përgjegjësi i Zyrës/Turnit/Pikës kryen shpërndarjen bazuar në ngarkesën e punës së personelit në varësi.

- 2.2. Nëse, si rrjedhojë e shpërndarjes automatike të deklaratave doganore, nga ana e personelit të SVQ apo të Degës Doganore, konstatohet që një deklaratë është caktuar gabimisht nga sistemi për t'u procesuar më tej nga SVQ, Përgjegjësi i SVQ kontakton menjëherë formë elektronike (e-mail), me Përgjegjesin e Turnit/Zyrës/Pikës operacionale në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, në adresën e dedikuar '@dogana.gov.al'/Asycuda World(apo anasjelltas), i cili manualisht duhet të kryejë rishpërndarjen bazuar në ngarkesën e punës së personelit në varësi.
- 2.3. Kontrolli fizik kryhet duke zbatuar me rigorozitet procedurat e përcaktuara në Manualin e Kontrollit Fizik (përcjellë Degëve Doganore me shkresën nr. 24909, datë 31.10.2017).
- 2.4. Me përfundimin e kontrollit fizik, rezultatet e kontrollit të kryer dhe/ose gjetjet përkatëse përshkruhen në mënyrë të detajuar në Aktin e Kontrollit në AW. Doganieri që kryen kontrollin fizik, me përfundimin e plotësimit të Aktit të Kontrollit, dërgon deklaratën 'në pritje' duke kryer veprimin në sistem 'Re-route to Query'. Vetëm pas këtij veprimi, praktika doganore mund të përpunohet nga doganieri i ngarkuar për verifikimin dokumentar në SVQ. Doganieri i kontrolli fizik në Degë Doganore mbetet në pritje të orientimeve/kërkesave përkatëse nga SVQ.
- 2.5. Procedurat që ndiqen nga personeli doganor i SVQ, në rastin e deklaratave të përzgjedhura në kanalin e kuq, janë të njëjta me ato të përshkruara në pikën që trajton procedurat për përzgjedhjen në kanalin e verdhë.
- 2.6. Komunikimi lidhur me orientime/kërkesa të ndryshme që mund të nevojiten nga SVQ me Degën Doganore kryhet nga adresa zyrtare e postës elektronike '@dogana.gov.al'/Asycuda World Mail.
- 2.7. Në funksion të komunikimit ndërmjet personelit doganor të SVQ dhe Degëve Doganore, në serverin 192.168.1.141 është krijuar një 'dosje' (share folder) me qëllim depozitim të fotove/materialeve nga doganieret e kontrollit fizik të Degëve Doganore. Kjo 'dosje' (share folder) do të popullohet me 'nën-dosje' (subfolder) të emërtuara sipas Degëve/zyrave Doganore ku brenda tyre janë të përcaktuara me 'nën-dosje' (subfolder) muajt dhe datat.
- 2.8. Të gjitha fotot/materialet që depozitohen në to duhet të përmbajnë si emërtesë një format ku të shënohet numri ('R') i deklaratës dhe kur janë më shumë se njëfoto/materiale për secilën numër ('R') deklarate (sipas datës përkatëse), të shoqërohen me me numra 1, 2, 3 e në vijim. Format i emërtesës është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjitha Degët Doganore.

*Për shembull:*

*Për deklaratën me numër R1024, në 'nën-dosjen' (subfolder) përkatëse sipas datës së regjistrimit të deklaratës do të vendosen fotot/materialet me emërtesën R1024-1, R1024-2, R1024-3 e kështu me radhë, për aq foto/materiale sa duhen bashkëlidhur.*

- 2.9. Doganierët e kontrollit fizik të Degëve Doganore kanë të drejta vetëm për hedhjen e fotove/materialeve dhe shikimin e tyre, por jo për fshirjen/eliminimin e tyre, ndërsa personeli i SVQ vetëm për shikimin/printimin e tyre.

2.10. Ruajtja e këtyre të dhënave ruhet për një periudhë kohore 120 ditore.

**a) Konstatimi i shkeljeve doganore**

a.1) Nëse nga verifikimet që kryen, doganieri i verifikimit dokumentar në SVQ apo kontrollit fizik në Degën Doganore ku është depozituar deklarata doganore, gjen mospërputhje apo parregullsi (shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore), rezultatet e verifikimit/kontrollit të kryer dhe/ose gjetjet përkatëse përshkruhen në mënyrë të detajuar në Aktin e Kontrollit në AW. Në çdo rast, plotësohet edhe Akti i Vlerësimit nga doganieri i SVQ sipas Aneksit 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi, si dhe informohet deklaruesi dhe Dega Doganore për Aktin e Vlerësimit. Akti i Vlerësimit i njoftohet në formë elektronike (e-mail), deklaruesit (në adresën e depozituar pranë autoriteteve doganore) dhe Degës Doganore (Përgjegjës Zyre/Turni/Pike dhe doganierit të kontrollit fizik, në adresën zyrtare '@dogana.gov.al'/Asycuda World Mail) ku është depozituar deklarata doganore.

a.2) Ky formular bëhet pjesë e deklaratës doganore duke iu bashkëlidhur dokumentave të tjera të praktikës doganore. Në versionin elektronik në AW plotësohen referencat përkatëse për dokumentin me kodin 903. Në këtë rast krijohet një version i ri i deklaratës, të cilin sistemi e ruan së bashku me deklaratën origjinale.

a.3) Në vijim, Përgjegjësi i Zyrës/Turnit/Pikës dhe doganieri i kontrollit fizik, duhet të plotësojnë edhe Procesverbalin e Verifikimit të Shkeljeve (bazuar në Aktin e Vlerësimit dhe Aktin e Kontrollit në AW), sipas Manualit Udhëzues Mbi Zbatimin e Dispozitave Lidhur me Shkeljet në Fushën Doganore dhe Akcizës. Procedurat në vijim, pas hartimit të Procesverbalit të Verifikimit të Shkeljeve përcaktohen në manualin e sipërcituar. Në rastin e aplikimi të nënshkrimit elektronik, Procesverbali i Verifikimit të Shkeljeve do të hartohet dhe nënshkruhet nga struktura konstatuese e shkeljes doganore (SVQ apo Degë Doganore).

a.4) Vendimi i arsyetuar i Kryetarit të Degës Doganore merret në përputhje me nenin 276 të Kodit Doganor. Kundër vendimit, personit të interesuar i lind e drejta e ankimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në përputhje me nenet 281 dhe 282, të Kodit Doganor.

a.5) Vetëm pasi në sistem të jenë reflektuar dhe pranuar ndryshimet e mësipërme, Përgjegjësi i turnit në SVQ miraton çlirimin për konsum të mallrave duke kryer veprimet përkatëse në sistemin AW, deklarata konsiderohet e pranuar dhe sistemi cakton automatikisht një numër serial që fillon me 'P'. Ky numër (numri i pranimit) do të shfaqet në rubrikën 'B' të DAV.

a.6) Përgjegjësi i Turnit/Zyrës/Pikës operationale në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, pas marrjes së numrit serial 'P' dhe 'M', kryen këto veprime:

- firmos e vulos me vulën datore në kutinë C të DAV. Vula duhet të përmbajë shënimin: "U zhdoganua";
- printon në format A4 Urdhrin e Çlirimit;
- i jep deklaruesit kopjen e DAV që i takon atij bashkë me Urdhrin e Çlirimit.

a.7) Në rastin e aplikimi të nënshkrimit elektronik, Përgjegjësi i SVQ pas marrjes së numrit serial 'P' dhe 'M' firmos e vulos elektronikisht në DAV. Në këtë rast Përgjegjësi i Turnit/Zyrës/Pikës operationale në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore,

printon në format A4 Urdhrin e Çlirimit dhe i jep deklaruesit kopjen e DAV që i takon atij bashkë me Urdhrin e Çlirimit.

#### IV) PROCEDURAT QË NDIQEN NGA SKAO

##### 1. Përzgjedhja në kanal blu

- 1.1. Nëse deklarata është përzgjedhur në kanalin blu, kjo do të thotë që brenda 5 ditësh pas çlirimit të mallrave, personeli i Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ (SKAO) do verifikojë saktësinë dhe plotësinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes, deklaratën e rieksporit ose në njoftimin e rieksporit, si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqërues.
- 1.2. Sistemi AW i mundëson personelit të SKAO shpërndarjen automatike të deklaratave doganore. Nëse kjo shpërndarje për shkaqe objektive nuk realizohet automatikisht, përgjegjësi i turnit të SKAO, kryen shpërndarjen bazuar në ngarkesën e punës së personelit në varësi.
- 1.3. Në çdo rast deklaruesi njoftohet elektronikisht që deklarata do të jetë objekt i kontrollit të paszhdoganimit.
- 1.4. Nëse deklarata përzgjidhet në kanalin “blu”, deklarata konsiderohet e pranuar dhe sistemi i cakton automatikisht një numër serial që fillon me P. Ky numër (numri i pranimit) do të shfaqet në kutinë B të DAV.
- 1.5. Përgjegjësi i Turnit/Zyrës/Pikës operacionale në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, pas marrjes së numrit serial ‘P’ dhe ‘M’, kryen këto veprime:
  - verifikon që në rastet kur hedhja e mallrave në qarkullim të lirë kushtëzohet nga procedura paraprake (p.sh.: ushtrimi i kontrolleve sanitare/fitosanitare) apo dorëzimi i lejeve/licencave/autorizimeve, kontrollon kryerjen e këtyre procedurave dhe/ose dokumenteve përkatës;
  - firmos e vulos me vulën datore në kutinë C të DAV. Vula duhet të përmbajë shënimin: “U zhdoganua pa u kryer kontroll”;
  - printon në format A4 Urdhrin e Çlirimit, i cili është e mundur të printohet vetëm pasi është bërë pagesa;
  - i jep deklaruesit kopjen e DAV që i takon atij bashkë me Urdhrin e Çlirimit.
- 1.6. Në rastin e aplikimit të nënshkrimit elektronik, kur hedhja e mallrave në qarkullim të lirë kushtëzohet nga procedura paraprake (p.sh.: ushtrimi i kontrolleve sanitare/fitosanitare) apo dorëzimi i lejeve/licencave/autorizimeve, deklaruesi është përgjegjës për kryerjen e tyre dhe depozitimit të dokumentacionit përkatës elektronik. Pas marrjes automatikisht të numrit serial ‘P’ dhe ‘M’, Përgjegjësi i Turnit/Zyrës/Pikës operacionale në Degën e Doganës ku është depozituar deklarata doganore, printon në format A4 Urdhrin e Çlirimit dhe i jep deklaruesit kopjen e DAV që i takon atij bashkë me Urdhrin e Çlirimit.

- 1.7. Nga ky moment deklarata doganore është objekt i procedurave të verifikimit pas zhdoganimit nga ana e Sektorit të Kontrollit Aposteriorit Operativ (SKAO) brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh.
- 1.8. Doganieri i SKAO verifikon:
- nëse dokumentet shoqëruese të deklaratës janë të besueshme dhe nëse i plotësojnë kërkesat e parashikuara nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore;
  - nëse të dhënat e deklaruara përputhen me ato që përmbajnë dokumentet shoqëruese;
- 1.9. Më pas vijon me kontrollin për saktësinë e të dhënave që përmban një deklaratë doganore:
- a) Klasifikimin tarifor;
  - b) Origjinën e mallrave;
  - c) Licenca, leje, autorizime, etj. (në rast se importi i mallrave kushtëzohet prej tyre);
  - d) Vlerësimin doganor;
  - e) Etj.

**a) Kontrolli mbi klasifikimin tarifor**

Në lidhje me kontrollin e klasifikimit tarifor doganieri i kontrollit dokumentar sigurohet që:

a.1) përshkrimi tregtar i mallit t'i korrespondojë përshkrimit të kodit tarifor të deklaruar sipas Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave (NKM). Klasifikimi tarifor duhet të verifikohet nëse është në përputhje me Rregullat e Përgjithshme të Interpretimit, Shënimet e Seksionit dhe Kapitullit përkatës. Në rast se ekzistojnë ende paqartësi në lidhje me klasifikimin tarifor, atëherë duhet të konsultohen Notat Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar të OBD apo të BE;

*Për shembull:*

- T'i kushtohet vëmendje pozicioneve 'përgjithësuese', emërtimeve të tilla si 'të tjera – të tjera – të tjera' dhe sidomos në rastet kur niveli tarifor i kodit me përshkrimin 'të tjera' është më i ulët se niveli tarifor i kodeve tetëshifrore të të njëjtit kre të NKM.
- T'i kushtohet vëmendje mallrave të cilat janë të përbëra nga pjesë të ndryshme (sete, duzina, komplete) nëse plotësohen kushtet e rregullit Interpretues të NKM 3b, që ka të bëjë me klasifikimin e "mallrave të vendosura në grupe për shitje me pakicë".
- T'i kushtohet vëmendje klasifikimit të mallrave për të cilat ka udhëzime klasifikimi nga DPD.

a.2) operatori ka aplikuar për Informacion Detyrues Tarifor (ITD) dhe klasifikimi tarifor i dhënë me ITD i korrespondon në çdo detaj mallit të deklaruar. T'i kushtohet vëmendje plotësimin të kodit përkatës shtesë në sistemin AW në rubrikën përkatëse të DAV për ITD e lëshuara. Nëse ka paqartësi për ITD mund të kërkohet mendim më i specializuar pranë Sektorit të Tarifës.

a.3) është kryer më parë një verifikim dhe analizë e të njëjtit lloj malli nga Laboratori Doganor, me qëllim përcaktimin dhe klasifikimin tarifor të mallrave.

**b) Kontrolli mbi origjinën e mallrave**

Në lidhje me kontrollin e origjinës së mallrave doganieri i kontrollit dokumentar sigurohet që:

- b.1) prova e origjinës të jetë lëshuar në momentin e eksportit ose kur eksporti është siguruar. Vërtetimi i origjinës preferenciale është i vlefshëm për katër muaj nga data e lëshimit në palën eksportuese, dhe duhet depozituar brenda kësaj periudhe tek autoritetet doganore;
- b.2) formulari i certifikatës EUR.1 duhet të përmbajë ekstremitetet dhe kushtet e parashikuara në protokollet përkatëse të rregullave të origjinës preferenciale në Marrëveshjet e Tregtisës së Lirë në fuqi (MTL);
- b.3) të krahasohen vultat e Certifikatave të Origjinës EUR.1 (në kutinë nr 11) me specimentet e përcjella nga doganat homologe dhe
- b.4) të verifikohet formati i numrit të autorizimit në rastet e deklaratave-faturë të lëshuara nga eksportues të miratuar, me modelet e përcjella nga doganat homologe apo Komisioni Europian;
- b.5) vlera totale e produkteve origjinuese nuk duhet t'i kalojë 6,000 euro nëse prova e origjinës është një deklaratë faturë;
- b.6) në rastet e deklaratave-faturë të lëshuara nga eksportuesit duhet të sigurohet që:
- teksti i deklaramit të origjinës në faturë (apo në ndonjë dokument tjetër tregtar) është sipas anekseve përkatëse të MTL-ve, si dhe
  - firma origjinale të eksportuesit është e shkruar me dorë (përjashtim nga firma origjinale bën eksportuesi i miratuar, i cili mund të mos i nënshkruajë këto deklarata);
- b.7) operatori ka aplikuar për Informacion Detyrues të Origjinës (IDO) dhe origjina e dhënë me IDO i korrespondon në çdo detaj mallit të deklaruar. T'i kushtohet vëmendje plotësimit të kodit përkatës shtesë në sistemin AW në rubrikën përkatëse të DAV për IDO e lëshuara. Nëse ka paqartësi për IDO, mund të kërkohet mendim më i specializuar pranë Sektorit të Origjinës.
- b.8) të zbatohen kushtet dhe udhëzimet (nëse ka të tilla) për mallra të caktuara;
- b.9) të konsultohet baza e të dhënave e shkeljeve doganore, nëse është kyer më parë një verifikim nga homologët lidhur me origjinën e mallit për produktin në fjalë, nga i njëjti vend origjine i deklaruar në DAV.

**c) Licenca, leje, autorizime, etj. (në rast se importi i mallrave kushtëzohet prej tyre)**

Në rast se importimi i mallrave kërkon plotësimin e kushteve të veçanta (licenca, leje, autorizime, ndalime/kufizime), këto kërkesa verifikohen paraprakisht nga doganieri i SVQ.

**d) Kontrolli dhe shqyrtimi i vlerës doganore**

Në lidhje me kontrollin dhe shqyrtimin e vlerës doganore doganieri i kontrollit dokumentar sigurohet që:

d.1) deklarimi doganor përputhet me të dhënat dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur;

*Për shembull:*

- vlerat e faturave shoqëruese të blerjes janë të njëjta me ato të deklaruara në DAV;
- monedha e deklaruar në DAV përkon me atë të shprehur në faturat shoqëruese;
- vlera e treguar në faturat shoqëruese është në përputhje me urdhrat e blerjes, kontratat, korrespondencat, etj. T'i kushtohet vëmendje nëse ekzistojnë reduktime ose kompensime në faturat e blerjes, si pasojë e transaksioneve të tjera;
- kushti i lëvrimin të mallrave dhe mënyra e pagesës të deklaruar në DAV, përputhet me dokumentacionin e mallrave;

d.2) rubrikat përkatëse të DAV-it janë të plotësuara në mënyrë korrekte dhe pa mangësi;

d.3) referencat (numër/datë) dhe kodifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur DAV pasqyrohet në mënyrë korrekte;

d.4) fatura që shoqëron mallrat përmban elementët kryesorë për kryerjen e vlerësimit doganor, të tilla si: numri i artikujve, sasia, çmimi për njësi, numri, data, përshkrimi i mallit, kushti i lëvrimin të mallrave;

d.5) Kur doganieri i SKAO, pas verifikimeve të kryera, arrin në konkluzionin që deklarimi dhe dokumentacioni mbështetës janë korrekte ose për gabime, të cilat rast pas rasti, nuk vlerësohen si shkelje doganore, atëhere rezultatet e kontrollit të kryer dhe/ose gjetjet përkatëse përshkruhen në mënyrë të detajuar në Aktin e Kontrollit në AW.

d.6) Deklarata konsiderohet e pranuar dhe sistemi cakton automatikisht një numër serial që fillon me 'P/1'. Ky numër (numri i ri i pranimit) do të shfaqet në rubrikën 'B' të DAV. Në këtë rast krijohet një version i ri i deklaratës, të cilin sistemi e ruan së bashku me deklaratën origjinale. Gjenerimi i këtij numri, do të konsiderohet edhe si njoftim për deklaruuesin.

d.7) Kur doganieri i SKAO, mbështetur në analizën e riskut, ka dyshime të arsyeshme se vlera e deklaruar e transaksionit nuk përfaqëson shumën totale të paguar ose të pagueshme, siç referohet në pikën 1, të nenit 66, të Kodit, mund të kërkojë nga deklaruesi të japë informacione shtesë (në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor, Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore në fuqi lidhur me vlerësimin e mallrave për qëllime doganore) dhe gjithashtu deklaruesi është i detyruar që të japë informacion dhe dokumente shtesë lidhur me:

- vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura;
- informacion ose dokumente shtesë, të nevojshme, për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave.

d.8) Në qoftë se përsëri mbeten dyshime, doganieri i SKAO mund të vendosë që vlera e mallit nuk mund të përcaktohet në përputhje me pikën 1, të nenit 66, të Kodit. Doganieri i SKAO, mbështetur në nenin 7.3, të Marrëveshjes për Zbatimin e nenit 7, të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT1994), informon deklaruesin për Aktin e Vlerësimit. Akti i Vlerësimit plotësohet sipas Aneksit 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe duhet të sqarojë dyshimet e arsyeshme, rivlerësimin dhe metodën e vlerësimit të përdorur për llogaritjen e vlerës doganore të mallit të importuar. Ky formular bëhet pjesë e deklaratës doganore duke iu bashkëlidhur dokumentave të tjera të praktikës doganore. Në versionin elektronik në AW plotësohen referencat përkatëse për dokumentin me kodin 903.

d.9) Njoftimi lidhur me Aktin e Vlerësimit i njoftohet, në formë elektronike (e-mail), deklaruesit (në adresën e depozituar pranë autoriteteve doganore) dhe Degës Doganore [specialistit (C1) pranë Sektorit të Zyrës së mbikëqyrjes doganore apo Përgjegjësit të Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1)], në adresën zyrtare '@dogana.gov.al'/Asycuda World Mail) ku është depozituar deklarata doganore.

d.10) Dega Doganore menjëherë merr masa për njoftimin shkresor të Deklaruesit i cili ka detyrimin për informimin e importuesit.

d.11) Brenda 10 ditëve nga informimi, deklaruesi mundet të ankohet me shkrim ndaj Aktit të Vlerësimit pranë Degës Doganore ku është depozituar deklarata. Dega Doganore komunikon në formë elektronike (e-mail), me personelin e SKAO në adresën e dedikuar '@dogana.gov.al'/AW Mail nëse nevojiten sqarime të mëtejshme në lidhje me Aktin e Vlerësimit. Vendimi i arsyetuar i Kryetarit të Degës Doganore i komunikohet me shkrim deklaruesit brenda 5 ditëve nga depozitimi i ankimit. Kundër vendimit, personit të interesuar i lind e drejta e ankimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Në këtë rast, nenet 281 dhe 282, të Kodit, aplikohen *mutatis mutandis*.

d.12) Nëse gjendja e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi i Kryetarit të Degës Doganore, lajmërohet elektronikisht deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së mbikëqyrjes doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar shumën përkatëse në llogarinë parapaguese.

d.13) Me plotësimin e llogarisëparapaguese, në të gjitha rastet e rivlerësimit, nga ana e doganierit të SKAO do të ndërhyhet në rubrikën 43 të DAV-it për metodën e vlerësimit doganor si dhe në rubrikën 45 të DAV-it me koeficientin e ri të vlerës së mallit të rivlerësuar dhe rezultatet e kontrollit të kryer dhe/ose gjetjet përkatëse pasqyrohen në mënyrë të detajuar në Aktin e Kontrollit në AW. Deklarata konsiderohet e pranuar dhe sistemi cakton automatikisht një numër serial që fillon me 'P/1'. Ky numër (numri i ri i pranimit) do të shfaqet në rubrikën 'B' të DAV. Në këtë rast krijohet një version i ri i deklaratës, të cilin sistemi e ruan së bashku me deklaratën origjinale. Gjenerimi i këtij numri, do të konsiderohet edhe si njoftim për deklaruesin.

## **2. Rastet e përzgjedhura nga kanalet e tjera**

2.1. Me qëllim rikontrolli një përqindje e deklaratave të pranuar në sistem ditën paraardhëse nga kanalet e tjera, përpos atyre blu, do të nënshtrohen kontrollit aposterior operativ nga SKAO, bazuar mbi elementët e riskut apo përzgjedhje rastësore si dhe ngarkesën e këtij sektorit, sipas kritereve të përcaktuara nga Sektori i Përpunimit të të Dhënave dhe Analizave në bashkëpunim me strukturat e TI.

2.2. Kriteret e përcaktuara bazohen në indikatorë si natyra e mallit, vlera e transaksionit, origjina, kushtet e lëvrimit, etj dhe janë të ndryshueshme në varësi të objektivave të Departamentit Operativ Hetimor.

2.3. Nëse shpërndarja e deklaratave për shkaqe objektive nuk realizohet automatikisht, deklaratat e përzgjedhura nga Sektori i Përpunimit të të Dhënave dhe Analizës i Drejtorisë së Kontrolleve të Paszhdoganimit i përcillen elektronikisht SKAO dhe përgjegjësi i turnit të SKAO, kryen shpërndarjen bazuar në ngarkesën e punës së personelit në varësi

- 2.4. Për të gjithë deklaratat e përzgjedhura, procedurat e ndjekura nga SKAO janë të njëjtat sipas Kreut, IV, pika 1.

### 3. Konstatimi i shkeljeve doganore

- 3.1. Nëse nga verifikimet që kryen, doganieri i SKAO, gjen mospërputhje apo parregullsi (shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore), rezultatet e verifikimit dhe/ose gjetjet përkatëse përshkruhen në mënyrë të detajuar në Proces-Verbalin sipas Manualit Udhëzues Mbi Zbatimin e Dispozitave Lidhur me Shkeljet në Fushën Doganore dhe Akcizës proces verbal i cili nënshkruhet nga doganieri përkatës dhe përgjegjësi i sektorit.
- 3.2. Proces-Verbali sipas gjermës (e.1) i njoftohet shkelësit brenda 5 ditëve kalendarike. Në proces-verbal përcaktohet dhe e drejta e shkelësit për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga e nesërmja e marrjes së njoftimit pranë strukturës përkatëse.
- 3.3. Drejtoria e Kontrollit Pas Zhdoganimit pas shqyrtimit të pretendimeve dërgon menjëherë pranë Degës Doganore ku është depozituar deklarata proces-verbalin përfundimtar së bashku me pretendimet e shkelësit, nëse ka të tilla.
- 3.4. Vendimi i arsyetuar i Kryetarit të Degës Doganore merret në përputhje me nenin 276 të Kodit Doganor. Kundër vendimit, personit të interesuar i lind e drejta e ankimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në përputhje me nenet 281 dhe 282, të Kodit Doganor.
- 3.5. Nëse gjendja e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi i Kryetarit të Degës Doganore, lajmërohet elektronikisht deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së mbikëqyrjes doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar shumën përkatëse në llogarinë parapaguese.
- 3.6. Me plotësimin e llogarisë parapaguese, në të gjitha rastet, nga ana e specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së mbikëqyrjes doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1) do të ndërhyhet në rubrikën 43 të DAV-it për metoden e vlerësimit doganor si dhe në rubrikën 45 të DAV-it me koeficientin e ri të vlerës së mallit të rivlerësuar dhe rezultatet e kontrollit të kryer dhe/ose gjetjet përkatëse pasqyrohen në mënyrë të detajuar në Aktin e Kontrollit në AW. Deklarata konsiderohet e pranuar dhe sistemi cakton automatikisht një numër serial që fillon me 'P/1'. Ky numër (numri i ri i pranimit) do të shfaqet në rubrikën 'B' të DAV. Në këtë rast krijohet një version i ri i deklaratës, të cilin sistemi e ruan së bashku me deklaratën origjinale. Gjenerimi i këtij numri, do të konsiderohet edhe si njoftim për deklaruesin.

### V) BASHKEPUNIMI NDERMJET STRUKTURAVE

1. Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degët Doganore bashkëpunojnë ngushtësisht me Drejtorinë e Kontrollit Pas Zhdoganimit (Aposterior Operativ 5 ditor) dhe Drejtorinë e Vlerësimit në Qendër duke bërë të mundur sigurimin e të gjithë

informacionin teknik të nevojshëm, në drejtim të realizimit të detyrave funksionale dhe marrjes së vendimeve të drejta.

2. Gjatë zbatimit të detyrave funksionale dhe procedurave standarde të operimit, personeli doganor i SVQ dhe SKAO, bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë ngushtësisht, në kohë reale, me strukturat doganore nëpër Degë Doganore si dhe strukturat operative të D.P.D. në terren te cilat kanë detyrimin për t'u përgjigjur menjëherë, brenda afateve të kërkuara.

## VI) DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Deri në funksionimin e deklaramit pa letër (online) dhe nënshkrimit elektronik, kopjet origjinale të Akteve të Vlerësimit të mbajtura nga SVQ dhe SKAO (pjesë e praktikës doganore elektronike), si rregull i përgjithshëm, i përcillen një herë në muaj Degëve Doganore përkatëse, duke u bërë pjesë e praktikave doganore të arkivuara.
2. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, të gjitha strukturat e përmendura në këtë udhëzim.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi në datë 27.01.2018.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Belinda IKONOMI**





**FORMULAR MBI RIVLERËSIMIN DOGANOR  
PER AUTOMJETET Kodi (8703)**

Zyra Vlerësimi

Aposteriori (5-ditor)

**I. Të dhëna të përgjithshme:**

Zyra	Punonjësi	Agjencia doganore	Importuesi	DAV
				R_____, dt. __/__/201__

**II. Informacion i detajuar për artikujt që rivlerësohen:**

Artikujt/Transporti	Kodi	Lëvrimi	Originë	Njësi	Çmimi	Mon.	Çmimi Rregulluar	Komente

**III. Shqyrtimi dhe analiza**

Dokumentacioni shoqërues, komente

---

---

---

---

**IV. VENDIMMARRJA:**

Metoda 2

Metoda 3

Metoda 6

Komente:

---

---

---

---

Vitet e përdorimit:

Deri në 10 vjet

Mbi 10 vjet

Komente:

---

---

---

---

**Punonjësit**

---

---

**Deklaruesi/Përfaqësuesi**

---

---

Nënshkrimi/Njoftohet me e-mail.

---

\_\_\_\_\_, më \_\_/\_\_/20\_\_



## FORMULAR MBI RIVLERËSIMIN DOGANOR

Zyra Vlerësimit

Aposteriori (5-ditor)

### I. Të dhëna të përgjithshme:

Zyra	Punonjësi	Agjencia doganore	Importuesi	DAV
				R ____ / ____ /201

### II. Informacion i detajuar për artikujt që rivlerësohen:

Artikujt ose Transporti	Kodi	Lëvrimi	Origjinë	Njësia	Çmimi Deklaruar	Mon.	Çmimi Aplikuar

### III. SHQYRTIMI DHE ANALIZA

Dokumentacioni shoqëruar komente:

---

---

---

---

---

---

### IV. VENDIMMARRJA:

Metoda 2

Metoda 3

Metoda 4

Metoda 5

Metoda 6

Argumentimi sa më i plotë për procesin dhe mënyrën e vlerësimit doganor;

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

**V. Detyrime Doganore shtesë**

---

---

---

**Punonjësit**

---

---

---

\_\_\_\_\_ , më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /20\_\_

**Deklaruesi/Përfaqësuesi**  
Nënshkrimi/Njoftohet me e-mail.

---

---